



UDHËZIME RRETH PROGRAMIT TË VIZAVE EMIGRUESE TË SHUMËLLOJSHMËRISË (LOTARISË AMERIKANE) (DV-2024)

Një vështrim i përgjithshëm i programit

Departamenti i Shtetit administron në bazë vjetore Programin e vizave emigruese të shumëllojshmërisë, të krijuar në mënyrë statutore. Seksioni 203(c) i Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë (INA) mundëson viza për një grup të njohur si “emigrantësh të shumëllojshmërisë”, prej vendeve me shkallë historikisht të ulët emigrimi në Shtetet e Bashkuara. Për vitin fiskal 2024, do të jenë në dispozicion 55,000 viza emigrantësh të shumëllojshmërisë (DV). Regjistrimi për në programin e Lotarisë është falas.

Aplikantët që janë përzgjedhur nga programi i lotarisë (“të përzgjedhurit”) duhet të plotësojnë kërkesa të thjeshta, por të rrepta, të pranimit në mënyrë që të kualifikohen për një vizë shumëllojshmërie. Departamenti i Shtetit përcakton të përzgjedhurit nëpërmjet zgjedhjes rastësore me anë të kompjuterit. Vizat e lotarisë shpërndahen ndërmjet gjashtë rajoneve gjeografike dhe asnjë vend i veçantë nuk mund të përfitojë më shumë se 7% të lotarive (DV-ve) të disponueshme për çdo vit.

Për Lotarinë DV-2024, vendasit e shteteve të mëposhtme nuk janë më të ligjshëm për të aplikuar, pasi këto shtete kanë dërguar në total më shumë se 50,000 emigrantë në SHBA në pesë vitet e shkuara:

Bangladesh, Brazil, Kanada, Kinë (duke përfshirë Hong Kongun SAR), Kolumbi, Republika Domenikane, San Salvador, Guatemala, Haiti, India, Xhamaika, Meksikë, Nigeri, Pakistan, Filipine, Koreja e Jugut, Mbretëria e Bashkuar (me përjashtim të Irlandës së Veriut) territoret e varura prej saj dhe Vietnam.

Personat e lindur në Makau SAR dhe Taivan janë të ligjshëm.

Kualifikimi:

Kërkesa #1: Individët të lindur në një [vend, vendasit e të cilit kualifikohen](#) për të aplikuar për programin e lotarisë, mund të jenë të pranueshëm për të aplikuar.

Nëse nuk keni lindur në një vend të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, ka dy mënyra me anë të të cilave ju mund të kualifikoheni.

- A ka lindur bashkëshorti/ja juaj në një vend të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë? Nëse po, ju mund të deklaroni vendin e lindjes së bashkëshortit/es në regjistrimin për lotarinë— me kushtin që emri juaj dhe i bashkëshortit/es të jetë i renditur në aplikimin e përzgjedhur, t'ju lëshohet viza, dhe të hyni në SHBA në të njëjtën kohë.
- A keni lindur në një shtet, vendasit e të cilit nuk janë të pranueshëm për të aplikuar për lotarinë, por asnjëri nga prindërit tuaj s'ka lindur, apo s'ka qenë rezident i ligjshëm atje në kohën kur ju

keni lindur? Nëse po, ju mund të deklaroni si vendlindje një nga vendlindjet e prindërve tuaj, nëse ky vend është vend i kualifikueshëm për programin e DV-2024. Për më shumë detaje mbi kuptimin e paragrafit të mësipërm, lexoni [Pyetje të Shtruara Shpesh](#).

Kërkesa #2: Çdo aplikant duhet të plotësojë ose kërkesën e arsimit ose kërkesën e eksperiencës së punës të programit të lotarisë, duke poseduar si vijon:

OSE

- Një arsim të shkollës së mesme apo ekuivalentin e tij, përkufizuar si përfundim me sukses i 12 viteve edukim të plotë zyrtar 9-vjeçar dhe i mesëm;

OSE

- dy vjet përvojë pune brenda pesë viteve të kaluara në një punësim që kërkon të paktën 2 vjet trajnim ose eksperiencë për ta ushtruar. Për të përcaktuar nëse përvoja e punës kualifikohet për lotarinë, do të përdoret Baza e të Dhënave të Departamentit Amerikan të Punës [O*Net OnLine](#).

Për më shumë informacion rreth eksperiencës së punës së kualifikueshme, lexoni [Pyetje të Shtruara Shpesh](#) më poshtë.

MOS aplikoni për Programin e Lotarisë në qoftë se ju nuk mund të plotësoni të dyja kërkesat e mësipërme.

Periudha e regjistrimit

Regjistrimet për Programin e Lotarisë DV-2024 duhet të kryhen në mënyrë elektronike në: <https://dvprogram.state.gov/>, duke nisur në mesditë 12:00, Ora Ditore Lindore (EDT) (GMT-4), e mërkurë, 5 tetor 2022, deri në mesditë 12:00, Ora Standarte Lindore (EST) (GMT-5), e martë, 8 nëntor 2022. Mos prisni deri në javën e fundit të periudhës së regjistrimit, pasi kërkesat e shumta mund të shkaktojnë mbingarkesë të faqes së internetit. Aplikimet me letër ose aplikimet e vonuara nuk do të pranohen. Ligji lejon vetëm një regjistrim për çdo person gjatë periudhës së regjistrimit. Departamenti i Shtetit përdor teknologji të sofistikuar për t'u vënë në dijeni të regjistrimeve të shumëfishta. **Individët që kanë aplikuar më shumë se një herë gjatë një periudhe regjistrimi do të s'kualifikohen.**

Plotësimi i regjistrimit elektronik për Programin e Lotarisë DV-2024.

Plotësoni Formularin Elektronik të Regjistrimit për Vizën e Shumëllojshmërisë (E-DV Entry Form ose DS-5501) online në faqen zyrtare <https://dvprogram.state.gov/>. Regjistrimet e papërfunduara nuk do të pranohen. Regjistrimi për Programin e Lotarisë është falas.

Ne ju rekomandojmë fuqimisht të plotësoni vetë formularin e regjistrimit, pa ndihmën e një "këshilluesi për viza", "agjenti të vizave" ose personave të tjerë që ju ofrojnë ndihmë. Nëse është dikush tjetër që ju ndihmon, duhet të jeni të pranishëm në momentin e përgatitjes së regjistrimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve në mënyrë sa më të saktë, të merrni fletën e konfirmimit dhe numrin e konfirmimit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të pajiseni me faqen e konfirmimit dhe numrin e konfirmimit. Pa këtë informacion, nuk do të jeni në gjendje të hyni në sistemin online, i cili do t'ju informojë mbi statusin e regjistrimit tuaj. Duhet të jeni të kujdesshëm në rastin kur dikush ofrohet të ruajë fletën tuaj të konfirmimit dhe numrin tuaj të konfirmimit. Ju gjithashtu duhet të keni akses tek

posta elektronike që keni vendosur tek regjistrimi juaj në E-DV. Lexoni [Pyetje të Shtruara Shpesh](#) për më shumë informacion rreth mashtrimeve të Vizave të Shumëllojshmërisë. Ju mund të shikoni [videon tonë](#) për t'u njohur me programin e vizave të shumëllojshmërisë, dhe udhëzime hap pas hapi që ju ndihmon të dorëzoni aplikimin tuaj.

Pasi të keni dorëzuar elektronikisht regjistrimin e plotë, juve do t'ju shfaqet një faqe konfirmimi, e cila përmban emrin tuaj dhe numrin tuaj unik të konfirmimit. Printojeni këtë faqe dhe ruajeni. Duke filluar nga 6 maji 2023, ju do të mund të kontrolloni statusin e regjistrimit tuaj në faqen zyrtare <https://dvprogram.state.gov/>, duke klikuar mbi *Kontrollin e Statusit të të Regjistruarit* dhe duke futur numrin unik të konfirmimit dhe informacionin personal. *Kontrolli i Statusit të të Regjistruarit* do të jetë e vetmja mënyrë informimi mbi përzgjedhjen tuaj për Lotarinë DV-2024 dhe, në rast se jeni përzgjedhur, mund të lexoni udhëzime se si të vazhdoni më tej me aplikimin tuaj. Qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk do t'ju informojë në mënyrë direkte. Në rast se jeni përzgjedhur dhe dorëzoni një aplikim për vizë, së bashku me dokumentacionin e kërkuar, duhet të përdorni *Kontrollin e Statusit të të Regjistruarit* për t'u informuar mbi datën e caktuar për intervistë.

Lexoni [Pyetje të Shtruara Shpesh](#) për më tepër informacion mbi procesin e përzgjedhjes.

Ju duhet të paraqisni informacionin e mëposhtëm për të plotësuar regjistrimin tuaj E-DV.

Në rast se nuk përfshini me kujdes të gjithë informacionin e kërkuar, nuk do të jeni të ligjshëm për këtë regjistrim:

1. Emrin – mbiemrin, emrin, emrin e mesit – ekzaktësisht siç shkruhet në pasaportë. **Mos vendosni emrin e babait si emër mesj, por vendosni N/A.**
2. Gjininë – mashkull ose femër.
3. Datën e lindjes – ditë, muaj, vit.
4. Qytetin e lindjes.
5. Shtetin e lindjes – Përdorni emrin me të cilin njihet aktualisht shteti ku keni lindur.
6. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë – Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë normalisht do të jetë i njëjtë me atë të lindjes. Vendi i kualifikueshëm për Programin e Lotarisë nuk lidhet me vendin ku jetoni. Nëse keni lindur në një vend jo të kualifikueshëm për Programin e Lotarisë, lutemi rishikoni [Pyetje të Shtruara Shpesh](#) për të parë nëse ka mënyrë tjetër që mund t'ju bëjë të kualifikueshëm.
7. Aplikuesit kryesor i duhet një pasaportë e paskaduar për udhëtim jashtë shtetit, numri i pasaportës, shteti i lëshimit të pasaportës dhe data e skadimit. Kjo kërkesë aplikohet vetëm për aplikuesin kryesor, dhe jo për vartësit e tij. Ju duhet të vendosni një pasaportë të vlefshme valide për udhëtime ndërkombëtare përveç nëse jeni pa shtetësi, ose i përkisni një kombësie të shteteve të kontrolluara nga komunizmi dhe për këtë nuk mund të merrni një pasaportë të atij shteti, ose jeni përfitues i përjashtimit individual të miratuar nga Sekretari i Departamentit të Sigurisë Kombëtare dhe Sekretari i Shtetit.

Në rast se nuk fusni informacionin e një pasaporte të vlefshme, nuk do të jeni të ligjshëm për një lotari (DV). Për më tepër informacion për të parë nëse plotësoni kushtet e përjashtimit, mund të lexoni pikën 12 te Pyetje të Shtruara Shpesh.

8. Fotografitë e të regjistruarve – Fotografi personale **pa syze**, të nxjerrë 6 muajt e fundit, për ju si aplikant kryesor, të bashkëshortit/es, si dhe të të gjithë fëmijëve të përfshirë në regjistrim. Shikoni [Dorëzimi i Fotografisë Dixhitale](#) për specifikime teknike dhe të kompozimit. Nuk është e nevojshme të përfshini një foto të bashkëshortes/it dhe fëmijëve tashmë qytetarë amerikanë ose Rezidentë të Përhershëm të Ligjshëm (me green card), por në rast se i përfshini nuk do të ketë pasoja në aplikimin tuaj për vizë shumëllojshmërie.

Fotografitë në grup nuk do të pranohen; duhet të paraqisni nga një fotografi për çdo individ. Regjistrimi juaj mund të skualifikohet ose viza juaj të refuzohet nëse fotografitë tuaja nuk janë të kohëve të fundit, janë të manipuluar në një formë apo në tjetrën, ose nuk respektojnë specifikimet e mëposhtme. **Nëse përfshini fotografi që e kishit përdorur në regjistrimin e vitit të kaluar, ju do të skualifikoni automatikisht, ndaj përdorni fotografi të nxjerrë kohët e fundit.**

Shikoni [Dorëzimi i Fotografisë Dixhitale](#) për më shumë informacion.

9. Adresa postare – Në emër të

Adresa Rreshti1
Adresa Rreshti 2
Qyteti/Vendi
Rajoni
Kodi Postar
Shteti

10. Shteti ku jetoni aktualisht.

11. Numri i telefonit.

12. Adresë E-maili - Një adresë poste elektronike në të cilën ju keni akses të drejtpërdrejtë. Nëse aplikimi juaj përzgjidhet dhe ju i përgjigjeni njoftimit të përzgjedhjes tuaj nëpërmjet *Kontrollit të Statusit të të Regjistruarit*, ju do të merrni e-maile të tjera komunikuese nga Departamenti i Shtetit duke ju njoftuar që informacion me detaje i intervistës për vizën emigruese është vendosur në Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve. **Departamenti i Shtetit kurrë nuk do t' ju dërgojë një e-mail duke ju thënë se ju jeni përzgjedhur për programin e DV-së.** Shikoni [Pyetjet të Shtruara Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me procesin e përzgjedhjes.

13. Niveli më i lartë i arsimimit që ju keni arritur, deri më sot: (1) vetëm Shkollë fillore, (2) disa vite shkollë të mesme, pa diplomë (3) Diploma e shkollës së mesme, (4) Shkollë profesionale, (5) Disa kurse universiteti, (6) Diplomë universitare, (7) Disa nivele të kurseve pasuniversitare, (8) Master, (9) Disa Kurse të doktoraturës, dhe (10) doktoraturë. Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me kërkesat arsimore.

14. Statusi aktual martesor – (1) I/e pamartuar, (2) i/e martuar dhe bashkëshorti/ja ime nuk është qytetarë amerikane, apo me green card, (3) i martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetarë amerikane, ose me green card, (4) i divorcuar, (5) i ve, ose (6) i ndarë ligjërisht. Vendosi emrin, datën e

lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, shtetin e lindjes së bashkëshortit/es tuaj, dhe një fotografi të bashkëshortit tuaj që plotëson specifikimet teknike të njëjta si fotoja juaj.

Mosvendosja e bashkëshortit/es tuaj në regjistrimin tuaj personal për lotarinë, ose vendosja e ndokujt që nuk është bashkëshorti/ja e juaj në regjistrimin për lotarinë, do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Ju duhet të përfshini në regjistrimin tuaj bashkëshortin/en tuaj edhe në qoftë se keni ndërmend të divorcoheni, përpara se të aplikoni për një vizë. Përvetse kur jeni i ndarë ligjërisht. Ndarja ligjore është një marrëveshje kur një çift mbetet i martuar, por jeton i ndarë, sipas një urdhri gjykate. Nëse ju dhe bashkëshorti juaj jeni të ndarë ligjërisht, bashkëshorti juaj nuk do të jetë në gjendje të emigrojë me ju përmes programit të Diversitetit Visa. Ju nuk do të penalizoheni nëse vendosni të shkruani emrin e një bashkëshorti nga i cili jeni ndarë ligjërisht. Nëse nuk jeni të ndarë ligjërisht nga një urdhër gjykate, ju duhet të përfshini bashkëshortin tuaj edhe nëse planifikoni të divorcoheni para se të aplikoni për Lotarinë

Nëse bashkëshorti/ja juaj është qytetar Amerikan apo Banor i Përhershëm i Ligjshëm, mos e përfshini atë tek aplikimi juaj. Një bashkëshort i cili tashmë është një qytetar Amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk do të kërkojë dhe as nuk do t'i lëshohet një vizë DV. Ndaj, nëse ju zgjidhni opsionin "i martuar dhe bashkëshorti/ja ime është qytetare amerikane, ose me green card" tek aplikimi juaj, sistemi nuk do t'ju kërkojë të vendosni informacionin për bashkëshortin/en. Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me anëtarët e familjes.

15. Numri i fëmijëve - Renditni Emrin, datën e lindjes, gjininë, qytetin e lindjes, dhe shtetin e lindjes për të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç në momentin e regjistrimit elektronik, pavarësisht nëse jetojnë apo jo me ju, apo s'kanë ndërmend t'ju shoqërojnë ose ndjekin për t'u bashkuar me ju të emigroni në Shtetet e Bashkuara. Ngarkoni fotografi individuale të secilit prej fëmijëve tuaj duke përdorur specifikimet teknike të njëjta si fotografia juaj.

Sigurohuni që të përfshini:

- të gjithë fëmijët e gjallë biologjikë;
- të gjithë fëmijët e gjallë ligjërisht të birësuar nga ju; dhe,
- të gjithë fëmijët/e bashkëshortit/es nga martesat e mëparshme që janë të pamartuar dhe nën moshën 21 vjeç në datën e aplikimit tuaj elektronik, madje edhe në qoftë se ju nuk jeni më të martuar ligjërisht me prindin e fëmijës, dhe madje edhe në qoftë se fëmija aktualisht nuk banon me ju dhe/ose nuk do të emigrojë me ju.

Fëmijët e martuar dhe fëmijët mbi moshën 21 vjeç nuk janë të pranueshëm për DV. Megjithatë, në rrethana të caktuara Akti i Mbrojtjes të Stausit të Fëmijëve i mbron fëmijët nga "përrjashtimi për shkak të moshës". Nëse aplikimi juaj i DV është bërë para se fëmija juaj i pamartuar të kishte mbushur 21 vjeç, dhe fëmija mbush 21 para lëshimit të vizës, ai/ajo mund të trajtohet sikur ai/ajo të ishte nën 21 për qëllimin e shqyrtimit të vizës.

Një fëmijë i cili tashmë është një qytetar amerikan apo një banor i ligjshëm i përhershëm nuk ka nevojë për një vizë diversiteti, dhe ju nuk do të penalizoheni për mospërfshirjen e anëtarëve të tillë të familjes në aplikimin tuaj.

Mospërfshirja në regjistrimin për lotarinë i të gjithë fëmijëve të cilët kanë të drejtë do të rezultojë në skualifikimin e aplikantit kryesor dhe të refuzimit të të gjitha vizave të rastit në kohën e intervistës për vizë. Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me anëtarët e familjes.

Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me Përfundimin e Aplikimit tuaj Elektronik për Programin DV-2024.

Përzgjedhja e Aplikantëve

Bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Të gjithë aplikantët e DV-2024 duhet të shkojnë tek *Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve* duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi për DV-2024 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV <https://dvprogram.state.gov/> duke filluar nga 6 maji 2023 deri më 30 shtator 2024.

Nëse aplikimi juaj është përzgjedhur, ju do të drejtoheni tek një faqe konfirmimi që do t'ju japë udhëzime të mëtejshme, përfshirë informacione për pagesat lidhur me procedurat e emigracionit për në Shtetet e Bashkuara. *Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve* do të jetë mjeti i VETËM me të cilin të përzgjedhurit do të njoftohen për përzgjedhjen e tyre për DV-2024. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë letra njoftimi ose të njoftojë të përzgjedhurit me email. Ambasadat e Shteteve të Bashkuara dhe konsullatat nuk do të sigurojnë lista për të përzgjedhurit. Individët të cilët nuk janë të përzgjedhur gjithashtu do të njoftohen VETËM përmes *Kontrollit të Statusit të Regjistrimit*. Ju jeni të inkurajuar fuqimisht të hyni vetë tek *Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve* dhe të mos mbështeteni tek dikush tjetër për të kontrolluar dhe për t'ju informuar.

Në mënyrë që të merrni një vizë DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, ju prapëseprapë duhet të përmbushni të gjitha kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit të SHBA-së. Formulari elektronik DS-260 – Aplikimi Online për Vizë Imigruese dhe i Regjistrimit të të Huajve, si dhe zyrtari konsullor, do t'ju pyesin mbi pranueshmërinë tuaj për të imigruar sipas Ligjit të Shteteve të Bashkuara. Këto pyetje përfshijnë tema në lidhje me sigurinë dhe krimin.

Të gjitha shqyrtimet e aplikimeve dhe lëshimi i vizave DV të aplikantëve të përzgjedhur që kanë plotësuar kërkesat e duhura edhe për anëtarët e familjes së tyre duhet të përfundojnë deri më 30 shtator 2024. Në asnjë rrethanë, Departamenti i Shtetit nuk mund të lëshojë DV-të dhe as USCIS nuk mund të miratojë apo të autorizojë pas kësaj date, dhe as anëtarët e familjes së DV-së të cilët nuk e morën vizën në të njëjtën kohë me aplikantin kryesor nuk mund t'i bashkohen aplikantit kryesor në Shtetet e Bashkuara pas kësaj date.

Shih [Pyetje të Bëra Shpesh](#) për më shumë informacion në lidhje me procesin e përzgjedhjes.

Dërgimi i një fotografie dixhitale (Fotografia)

Ju mund të nxirrni një fotografi të re dixhitale, pa syze, apo të skanoni një fotografi (të nxjerrë gjashtë muajt e fundit) me një skaner dixhital, për aq kohë sa ajo i plotëson specifikimet e renditura më poshtë. Fotografitë duhet të kenë të njëjtën cilësi dhe përbërje si fotografitë për vizë Amerikane. Ju mund të shikoni shembuj të fotografive të pranueshme [këtu](#). Mos ngarkoni një fotografi më të vjetër se gjashtë muaj apo një fotografi që nuk i përmbush të gjitha standartet e përkrahura më poshtë. Ngarkimi i të njëjtës fotografi që keni përdorur në regjistrimin e një viti më parë, një fotografi që është përpunuar, apo një fotografi që nuk i përmbush specifikimet më poshtë do të rezultojë në skualifikimin tuaj.

Fotografitë tuaja duhet të jenë:

- Me ngjyra
- Në fokus. Personi që fotografohet duhet të jetë me fytyrë drejt aparatit.
- Lartësia e kokës ose përmasa e fytyrës (matur nga maja e kokës duke përfshirë edhe flokët deri tek pjesa e poshtme e mjekrrës) duhet të jetë ndërmjet 22 mm dhe 35 mm ose nga 50% deri 69% të lartësisë totale të fotografisë.
- Të jetë nxjerrë brenda 6 muajve të fundit dhe të tregojë pamjen tuaj aktuale.
- Të jetë nxjerrë me një sfond të bardhë e të ndriçuar.
- Të jetë nxjerrë me fytyrën që shikon drejtpërdrejt kamerën. Koka e personit nuk duhet të jetë pozicionuar lart, poshtë ose anash.
- Me një shprehje neutrale të fytyrës dhe me sytë të hapur.
- Me rroba që vishni si zakonisht çdo ditë
- Nuk duhen veshur uniforma, përveç veshjeve fetare që vishen çdo ditë.
- Jo shami apo kapele që pengon flokët, përveç veshjeve fetare që vishen çdo ditë. Fytyra juaj duhet të jetë e dukshme dhe shamia e kokës nuk duhet të krijojë ndonjë hije në fytyrën tuaj.
- Kufjet, pajisjet wireless, apo të ngjashme janë të papranueshme në fotografinë tuaj.
- Hiqini syzet kur të dilni në fotografi.
- Nëse ju mbani një pajisje dëgjimi çdo ditë, ju mund ta mbani atë edhe kur të dilni në fotografi.

Shikoni [Shembuj Fotografish](#) për të parë shembuj të fotografive të pranueshme dhe të papranueshme. Fotografi të kopjuara nga leja e drejtimit apo nga dokumente të tjera zyrtare nuk janë të pranueshme. Gjithashtu, fotografi të çastit, fotografi nga revista, fotografi me cilësi të ulët apo të bëra me celular me cilësi të ulët, nuk janë të pranueshme.

Ju duhet të ngarkoni fotografinë digjitale si pjesë e aplikimit për regjistrimin te programi i lotarisë. Fotografia digjitale duhet të jetë:

- në formatin JPEG (.jpg)
- baras ose më pak se 240 KB si madhësi
- Dimensioni i fotos duhet të jetë 600x600 pikselë

Dëshironi të skanoni një fotografi të printuar që e keni nxjerrë 6 muajt e fundit? Përveç kërkesave të fotografisë digjitale, fotografia juaj ekzistuese duhet të jetë:

- 51 x 51 mm (2 x 2 inç)
- E skanuar në një rezolucion prej 12 pikselë për milimetër (300 pikselë për inç)

Përdorni testuesin e fotografive të Departamentit të Shtetit, i cili është falas për të:

- Zgjedhur një fotografi të ruajtur në kompjuterin tuaj
- Riformatuar dhe rrotulluar atë nëse është e nevojshme
- Ta presësh në një format katror saktësisht 600 x 600 pikselë

Nxjerrja e fotografive të fëmijës apo bebes tuaj

Kur të nxirrni në fotografi fëmijën tuaj nuk duhet të dalë ndonjë person tjetër në fotografi me të dhe fëmija duhet të shikojë në drejtim të aparatit fotografik me sytë e tij ose të saj të hapura.

Këshilla 1: Shtrijeni beben tuaj me shpinë mbi një çarçaf të bardhë. Kjo do të sigurojë që koka e fëmijës të jetë e mbështetur dhe të sigurojë një sfond të bardhë për fotografinë. Sigurohuni të mos krijohet hije mbi fytyrën e fëmijës, sidomos nëse ju jeni mbi të duke bërë fotografinë.

Këshilla 2: Mbuloni një ndenjese për fëmijë në makinë me një fletë ose çarçaf të bardhë dhe nxirreni në fotografi fëmijën tuaj në ndenjësën e makinës. Kjo gjithashtu do të sigurojë që koka e fëmijës suaj të jetë e mbështetur.

P Y E T J E T Ë B È R A S H P E S H

1. Çfarë do të thonë fjalët “vendas” dhe “ngarkimi”?

Vendas në përgjithësi do të thotë dikush i lindur në një vend të caktuar, pavarësisht se në cilin shtet jeton aktualisht personi dhe pavarësisht shtetësisë. Vendas gjithashtu do të thotë dikush i cili gëzon të drejtën t'i ngarkohet një shteti të ndryshëm nga shteti ku ka lindur, sipas dispozitave të Nenit 202(b) të Aktit të Emigracionit dhe Kombësisë.

Për shkak se ekziston një kufizim numerik ndaj emigrantëve që vijnë nga një shtet apo nga një rajon gjeografik, çdo individ i ngarkohet një shteti. Ngarkimi juaj i referohet shtetit ndaj kufizimit të të cilit ju llogariteni. Shteti juaj i ngarkimit do të jetë në përgjithësi i njëjtë me vendin tuaj të lindjes. Gjithsesi, ju mund të zgjidhni si vend të ngarkimit, shtetin e lindjes së bashkëshortit apo bashkëshortes suaj, ose shtetin e lindjes së njërit nga prindërit tuaj nëse ju keni lindur në një shtet të ndryshëm nga ai i prindërve dhe në të cilin prindërit tuaj nuk ishin rezidentë në kohën kur ju keni lindur. Këto janë tre mundësitë e vetme për të zgjedhur shtetin tuaj të ngarkimit.

Deklarimi i pasaktë i shtetit të ngarkimit (p.sh. një shtet ndaj të cilit ju nuk mund të siguronit një pretendim të vlefshëm) mund të s'kualifikojë regjistrimin tuaj.

2. A mund të aplikoj edhe nëse nuk kam lindur në një nga shtetet kualifikuese?

Ka dy rrethana në të cilat prapëseprapë ju mund të keni të drejtë për të aplikuar. E para, nëse bashkëshortja derivative ka lindur në një shtet të kualifikueshëm për lotarinë, ju mund të deklaroni ngarkimin ndaj atij shteti. Duke qenë se pranueshmëria juaj për aplikim bazohet tek bashkëshortja juaj, juve do t'ju lëshohet viza emigruese DV-1 vetëm nëse bashkëshortja juaj do të jetë gjithashtu e pranueshme për vizë dhe t'i lëshohet viza DV-2. Të dy ju duhet të hyni në SHBA së bashku duke përdorur vizën tuaj të DV-së. Në mënyrë të ngjashme, fëmija juaj i mitur mund “t'i ngarkohet” shtetit të lindjes së prindit.

Së dyti, juve mund t'ju "ngarkohet" vendi i lindjes të njërit prej prindërve tuaj për sa kohë që asnjëri prej prindërve nuk ka lindur në vendin që nuk kualifikohet, ose nuk ka qenë banor i vendit që nuk kualifikohet në kohën e lindjes tuaj. Në përgjithësi, njerëzit nuk konsiderohen banorë të një vendi në të cilin ata nuk kanë lindur ose janë natyralizuar ligjërisht, nëse ata janë vetëm duke vizituar vendin, duke

studiuar në vend përkohësisht, ose të vendosur përkohësisht në atë vend për biznes apo arsye profesionale në emër të një kompanie ose qeveri nga një vend tjetër dhe jo nga vendi ku aplikuesi ka lindur.

Nëse ju kërkoni ngarkim alternativ, ju duhet ta shënoni një informacion të tillë në Formularin elektronik të DV-së në internet, në pyetjen # 6.

Shënimi i një vendi që nuk kualifikohet ose ngarkohet (p.sh, një vend për të cilin nuk mund të vërtetoni një kërkesë të vlefshme) mund të përjashtojë aplikimin tuaj.

3. Përse vendasit e disa shteteve nuk kualifikohen për Programin e DV-së?

Programi i Lotarisë së Diversitetit (DV) ka për qëllim t'u ofrojë një mundësi emigrimi personave që nuk janë nga vende me "pranim të lartë emigrantësh". Ligji përcakton "shtetet pranim të lartë emigrantësh" ato shtete nga të cilat një total prej 50,000 personash në kategoritë e vizave me Bazë Të Sponsorizuar nga Familjarë dhe me Bazë Punësimi kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara gjatë pesë viteve të kaluara. Çdo vit, Shërbimi i Emigracionit dhe Shtetësisë Amerikane (USCIS) bën përlllogaritjen e shifrave të emigrantëve që janë pranuar në Amerikë me statusin e familjarit dhe të punësimit në pesë vitet e mëparshme për të identifikuar shtetet ku vendasit e tyre nuk do të jenë të kualifikueshëm (nuk do të kenë të drejtë të aplikojnë) për lotarinë e atij viti. Meqenëse bëhet një përcaktim i veçantë para çdo periudhe vjetore të kohës kur aplikohet për E-DV-në (lotarinë elektronike), lista e vendeve ku vendasit e tyre nuk janë të ligjshëm mund të ndryshojë nga viti në vit.

4. Sa viza të DV-2024 do u kalojnë vendasve të secilit rajon dhe shteteve të kualifikueshme?

Shërbimi i Shteteve të Bashkuara për Shtetësinë dhe Imigracionin (USCIS) përcakton limitet rajonale për DV-të për çdo vit sipas një formule të përcaktuar në Seksionin 203(c) të INA-s. Numri i vizave që do t'u lëshohen vendasve të secilit shtet do të varen nga caqet rajonale të përcaktuara, nga sa të regjistruar vijnë nga secili shtet, dhe se sa të regjistruar kanë patur të drejtën për vizë. Jo më shumë se shtatë përqind e totalit të vizave në dispozicion mund t'i kalojnë vendasve të një shteti.

5. Cilat janë kërkesat për arsim ose përvojë pune?

Ligji dhe rregullat e Emigracionit të Shteteve të Bashkuara kërkojnë që çdo aplikant duhet të ketë të paktën një arsim të shkollës së mesme ose ekuivalentin e saj, ose brenda pesë viteve të fundit të ketë dy vjet përvojë pune në një profesion që kërkon përvojë ose trajnim të paktën dy vjet. Një "arsimim i shkollës së mesme ose ekuivalente" përkufizohet si përfundimi me sukses i një kursi dymbëdhjetëvjeçar fillor dhe të mesëm në Shtetet e Bashkuara OSE përfundimin e suksesshëm në një vend tjetër të një kursi arsimit zyrtar të krahasueshëm me filloren dhe të mesmen të një shkolle në arsimin e mesëm në Shtetet e Bashkuara. Vetëm kurset zyrtare të studimit e përmbushin këtë kërkesë, kurset e korrespondencës, me kohë të pjesshme, ose çertifikata të ngjashme (të tilla si me kohë të pjesshme G.E.D.) nuk janë të pranueshme. Prova të dokumentuara të edukimit ose përvojës së punës duhet t'i prezantohen zyrtarit konsullor në kohën e intervistës për vizë.

Nëse ju nuk i përmbushni kërkesat për edukim ose për përvojë pune, regjistrimi juaj do të skualifikohet në ditën e intervistës për vizë dhe as juve e as anëtarëve të familjes suaj nuk do t'ju lëshohet vizë.

6. Cilat profesione kualifikohen për programin e DV-së?

Për të përcaktuar të drejtën ligjore bazuar në përvojën e punës, do të përdoren përkufizimet e publikuara në bazën e të dhënave të Departamentit të Punës (DOL) [O*Net OnLine Database](#). [O*Net OnLine Database](#) grupon përvojën e punës në pesë "zona të punës." Edhe pse shumë profesione janë të shënuara në faqen e internetit të Departamentit të Punës (DOL), vetëm disa profesione specifike të caktuara kualifikohen për programin e DV-së. Për t'u kualifikuar për një DV në bazë të përvojës suaj në punë, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në një shkallë të Përgatitjes së Vecantë Profesionale (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart.

Nëse ju nuk i përmbushni kërkesat për edukim ose për përvojë pune, regjistrimi juaj do të s'kualifikohet në ditën e intervistës për vizë dhe as juve e as anëtarëve të familjes suaj nuk do t'ju lëshohet vizë.

7. Si mund të gjej punët që të kualifikojnë për DV tek bazën e të dhënave të Departamentit të Punës (DOL) [O*Net OnLine Database](#)?

Pasi të keni hyrë në [O*Net OnLine](#), ndiqni këto hapa për të gjetur se cilat profesione kualifikohen:

1. Nën "Gjej Profesione", zgjidh "Familja e Profesioneve" nga lista poshtë;
2. Kërko sipas "Familjes së Profesioneve", kryeni zgjedhjen tuaj, dhe shtypni "Vazhdo";
3. Zgjidhni lidhjen për profesionin tuaj specifik.
4. Zgjidhni butonin "Zona e Profesionit" për të gjetur numrin e përcaktuar të Zonës së Profesionit dhe gamën e vlerësimit të Përgatitjes Specifike Profesionale (SVP).

Për shembull, zgjidhni Inxhinierët e Hapësirës. Në fund të Raportit Përmbledhës për Inxhinierët e Hapësirës, nën seksionin e Zonës së Profesionit, ju do të gjeni Zonën e përcaktuar të Profesionit 4, gama e SVP, 7.0 deri < 8.0. duke përdorur këtë shembull, Inxhinierët e Hapësirës është një profesion i kualifikueshëm.

Për më tepër informacion, shikoni faqen e internetit të [Vizave të Shumëllojshmërisë – Lista e Profesioneve](#).

8. A ka një moshë minimale për të aplikuar për programin e E-DV-së?

Nuk ka moshë minimale për të aplikuar për programin, por kërkesa për shkollim nga një shkollë e mesme ose përvojë pune për secilin aplikant primar në kohën e aplikimit do të ndikojë në s'kualifikimin e shumë personave që janë nën 18 vjeç.

PLOTËSIMI I FORMULARIT TUAJ ELEKTRONIK PËR PROGRAMIN E DV-së

9. Kur mund ta dorëzosh aplikimin tim?

Periodha e regjistrimit për aplikimin elektronik për DV-2024 do të fillojë nga ora 12:00 në mesditë, Ora Ditore Lindore (GMT-4), e mërkurë, 5 tetor 2022, dhe do përfundojë në orën 12:00 mesditë, Ora Standarte Lindore (GMT-4) e martë, 8 nëntor 2022. Çdo vit, miliona njerëz aplikojnë për programin e lotarisë gjatë periudhës së regjistrimit. Mbajtja e periudhës së regjistrimit në këto data siguron që të përzgjedhurit të njoftohen brenda afatit dhe u jep kohë për t'u përgatitur si aplikantëve të vizave ashtu dhe ambasadave e konsullatave tona që të plotësojë rastet për lëshimin e vizave.

Ju inkurajojmë që të aplikoni në fillim të periudhës së regjistrimit. Kërkesat e tepërta nga fundi i periudhës së regjistrimit mund të ngadalësojnë sistemin. Asnjë aplikim nuk do të pranohet pas mesditës (EST), e martë, 8 nëntor 2022.

10. Unë jam në SHBA. A mundem unë të aplikoj për programin e DV-së?

Po, një aplikant mund të jetë në Shtetet e Bashkuara ose në një shtet tjetër dhe aplikimi mund të kryhet nga kudo ndodheni.

11. Më duhet të aplikoj vetëm një herë gjatë periudhës së regjistrimit?

Po, ligji lejon vetëm një aplikim nga/ose për secilin person gjatë çdo periudhe të regjistrimit. Departamenti i Shtetit përdor teknologji të sofistikuar për të identifikuar aplikime të shumëfishta. **Individët që kanë dorëzuar më shumë se një aplikim do të s'kualifikohen.**

12. Pse më duhet pasaportë për të aplikuar në programin DV? A ka ndonjë përjashtim?

Kërkimi i një pasaportë të vlefshme, të pa skaduar, shton sigurinë në procesin e DV dhe ndihmon në mbrojtjen e hyrjes tuaj. Rregulli nuk zbatohet për fëmijët ose bashkëshortët e hyrësit kryesor. Pasaporta duhet të jetë e vlefshme për udhëtime ndërkombëtare. Pasaportat e brendshme, të lëshuara nga disa vende, nuk janë të vlefshme për qëllime të hyrjes në DV.

Përjashtimet nga Kërkesa për Pasaportë: Rregulloret e Departamentit të Shtetit parashikojnë tre përjashtime të kufizuara nga kërkesa për pasaportë. Këto tre përjashtime janë për: individë që janë pa shtetësi, shtetas të një vendi të kontrolluar nga Komunistët, të cilët nuk janë në gjendje të marrin një pasaportë nga qeveria e vendit të kontrolluar nga Komunistët, dhe përfituesit e heqjes dorë individuale të miratuar nga Sekretari i Sigurisë Kombëtare dhe Sekretari të shtetit. Nëse keni zgjedhur një nga këto përjashtime në hyrjen tuaj në DV, do t'ju kërkohet të shpjegoni se si e përmbushni përjashtimin që keni zgjedhur. Përjashtimet zbatohen vetëm për individët që nuk janë në gjendje të marrin një pasaportë. Nëse keni zgjedhur një përjashtim për shkak të një vonese në marrjen e një pasaportë, pavarësisht nëse ajo vonesë ishte brenda kontrollit tuaj, ju nuk kualifikoheni për një përjashtim dhe do të jeni të papërshtatshëm për një vizë shumëllojshmërie.

Individët pa shtetësi: Në përgjithësi, pashtetësia është një situatë e rrallë. Nëse në hyrjen tuaj të DV-së kontrolloni rutinë që i përgjigjet këtij përjashtimi, do t'ju kërkohet të paraqisni prova për të vërtetuar se nuk keni fituar shtetësinë e vendit tuaj të lindjes sipas ligjeve të atij vendi dhe se nuk keni ndonjë shtetësi tjetër .

Shtetasit e një vendi të kontrolluar nga Komunistët: Nëse, në hyrjen tuaj në DV, kontrolloni rutinë që i përgjigjet këtij përjashtimi, do t'ju kërkohet të siguronit prova për të vërtetuar se nuk jeni në gjendje të merrni një pasaportë nga qeveria e vendit tuaj të kombësisë.

Përfituesit e heqjes dorë individuale: Nëse, në hyrjen tuaj në DV, kontrolloni rutinë që i përgjigjet këtij përjashtimi, do t'ju kërkohet të siguronit dëshmi se nuk jeni në gjendje të merrni një pasaportë dhe arsyen e heqjes dorë nga pasaporta individuale, të tilla si :

1) Një vizë e mëparshme e SHBA lëshuar për ju në formularin DS-232 sepse nuk keni qenë në gjendje të merrni një pasaportë dhe se të njëjtat arsye që keni kërkuar më parë një heqje dorë nga pasaporta ende zbatohen;

2) Formulari I-193 i aprovuar nga USCIS sepse nuk keni qenë në gjendje të merrni një pasaportë dhe se ende vlejnë të njëjtat arsye që më parë keni kërkuar heqjen dorë nga pasaporta; ose

3) Dokumentacioni që tregon se ju është dhënë statusi i refugjatit në një vend tjetër nga vendi juaj i kombësisë sepse jeni përndjekur nga qeveria e vendit tuaj të kombësisë, duke e bërë të pamundur për ju të merrni një pasaportë nga ajo qeveri pa përjetuar dëm të mëtejshëm .

Përsëri, duhet të konsideroni të mos ndiqni një hyrje në programin e DV-së nëse nuk plotësoni arsimin kualifikues ose kërkesat e përvojës së punës të shpjeguar më lart, ose nëse nuk keni një pasaportë të vlefshme në kohën e hyrjes. Nëse zbulohet se nuk jeni të pranueshëm për një vizë të diversitetit, çdo tarifë që paguani për aplikimin për vizë nuk do të rimburohet.

13. Nëse pasaporta ime skadon ose e humbas para se të aplikoj për vizë?

Nëse numri i pasaportës tuaj ndryshon për ndonjë arsye, ju duhet të lajmëroni Qendrën Konsullore në Kentucky (KCC) dhe t'i dërgoni prova se pse ka ndryshuar numri i pasaportës, para se KCC t'ju caktojë intervistën tuaj për DV. Nëse keni aplikuar me një numër pasaporte false, të pasaktë ose të pavlefshme në aplikimin tuaj për DV, çështja juaj do të jetë i papërshtatshëm për programin e DV-së . Ne ju sugjerojmë të bëni një fotokopje të pasaportës që do të përdorni për aplikimin DV dhe ta ruani atë në një vend të sigurt me numrin tuaj të konfirmimit të aplikimit (FAQ # 27). Vetëm një fotokopje e pasaportës nuk është provë që keni dhënë një numër të vlefshëm të pasaportës në aplikimin tuaj, por mund t'ju ndihmojë të shpjegoni situatën. Vendimi përfundimtar bëhet nga Oficeri Konsullor gjatë intervistës suaj për DV.

14. A mundet secili nga bashkëshortët të dorëzojë aplikim veçmas?

Po, secili nga bashkëshortët mund të dorëzojë një aplikim veçmas, nëse secili përmbush kërkesat ligjore. Në qoftë se njëri prej tyre përzgjidhet, tjetri ka të drejtë të aplikojë për statusin e personit ndjekës (derivativ). Mos harroni: secili nga ju duhet të përfshijë bashkëshorti/en dhe çdo fëmijë të kualifikueshëm për lotarinë në aplikimin tuaj.

15. Cilët anëtarë të familjes duhet të përfshij unë në aplikimin tim elektronik për lotarinë?

Bashkëshorti/ja: Nëse jeni i martuar ligjërisht, duhet të renditni bashkëshortin tuaj pavarësisht nëse ai / ajo jeton me ju ose synon të emigrojë në Shtetet e Bashkuara. Ju duhet të renditni bashkëshortin tuaj edhe nëse aktualisht jeni të ndarë nga ai / ajo, përveç nëse jeni të ndarë ligjërisht. Ndarja ligjore është një marrëveshje kur një çift mbetet i martuar, por jeton i ndarë, pas një urdhri gjykate. Nëse ju dhe bashkëshorti juaj jeni të ndarë ligjërisht, bashkëshorti juaj nuk do të jetë në gjendje të emigrojë me ju përmes programit të Diversitetit Visa. Ju nuk do të penalizoheni nëse vendosni të shkruani emrin e një bashkëshorti nga i cili jeni ndarë ligjërisht. Nëse nuk ndaheni ligjërisht nga një urdhër gjykate, duhet të përfshini bashkëshortin tuaj edhe nëse planifikoni të divorcoheni para se të aplikoni për Vizën e Diversitetit.

Mosregjistrimi i bashkëshortit tuaj ose, duke renditur dikë që nuk është bashkëshorti juaj, do të bëjë që ju të mos jeni të kualifikuar për programin e DV-së. Nëse nuk jeni i martuar në kohën e hyrjes, por planifikoni të martoheni në të ardhmen, mos renditni një bashkëshort në formularin tuaj pasi kjo do t'ju skualifikojë në programin e DV-së. Nëse jeni të divorcuar ose bashkëshorti juaj ka vdekur, nuk keni pse të renditni ish-bashkëshortin tuaj.

Fëmijët: Ju duhet të përfshini të GJITHË fëmijët tuaj që janë të pamartuar dhe nën 21 vjeç në kohën e aplikimit tuaj fillestar E-DV, pavarësisht nëse janë fëmijët tuaj biologjikë, fëmijët e bashkëshortit/es tuaj

(edhe pse tashmë mund të jeni i ndarë nga prindi i fëmijës), fëmijët e bashkëshortit/es suaj, apo fëmijët që ju keni birësuar zyrtarisht në përputhje me ligjet e vendit tuaj. Përfshini të gjithë fëmijët nën 21 vjeç në kohën e aplikimit tuaj elektronik, edhe nëse ata nuk banojnë me ju apo nuk mendoni që ata do të emigrojnë në kuadrin e programit DV. Nuk ju kërkohet të përfshini fëmijët të cilët tashmë janë shtetas Amerikanë apo Rezidentë të Përherëshëm të Ligjshëm, sidoqoftë ju nuk do të cënoheni nëse i përfshini ata.

Prindërit apo motrat/vëllezërit e të regjistruarit nuk janë të kualifikueshëm për të përfutur statusin e personave në ngarkim, **dhe ju nuk duhet t'i përfshihni ata në formularin tuaj.**

Nëse përfshini pjesëtarët e familjes (bashkëshort/e dhe fëmijët që kualifikohen për lotarinë) në aplikimin tuaj, nuk është e domosdoshme për ta që të aplikojnë për vizë apo të udhëtojnë me ju. **Megjithatë, në qoftë se ju nuk arrini të përfshini në aplikimin tuaj për vizë një person i cili është në varësinë tuaj të ligjshme, dhe që nuk e keni përfshirë në aplikimin elektronik fillestar, ju do të të jeni të papërshtatshëm për programin e DV-së në ditë e intervistës, dhe as juve e as anëtarëve të familjes suaj nuk do t'ju lëshohet vizë.** Kjo vlen vetëm për ata që ishin anëtarë të familjes në kohën kur është dorëzuar aplikimi origjinal, jo ata të përfutur në një datë të mëvonshme nga aplikimi fillestar. **Bashkëshorti/ja juaj, nëse i përmbush kushtet për aplikim, mund të dorëzojë gjithashtu një formular më vete edhe pse ai/ajo është radhitur në aplikimin tuaj, për sa kohë që të dy aplikimet të përfshijnë detaje mbi të gjithë vartësit në familjen tuaj.** (shikoni [Pyetje të Bëra Shpesh #12](#) më sipër).

16. Duhet të aplikoj vetë, apo dikush tjetër mund të aplikojë për mua?

Ju inkurajojmë të përgatisni dhe dorëzoni aplikimin tuaj (aplikimin elektronik fillestar), por mund të keni edhe dikë tjetër që t'ju ndihmojë të aplikoni. Pavarësisht se nga kush është bërë aplikimi fillestar për lotarinë, pra nga vetë individi, apo nga një avokat, mik, i afërm, etj., vetëm një regjistrim mund të paraqitet në emrin tuaj. Ju si aplikant keni përgjegjësinë të siguroheni që informacioni i dërguar në formularin e regjistrimit është i saktë dhe i plotë; formularët që nuk janë të saktë dhe të plotë do të skualifikohen. Aplikantët duhet të ruajnë numrin personal të konfirmimit që të mundën në mënyrë të pavarur të kontrollojnë statusin e aplikimit të tyre nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit (Entrant Status Check) në <https://dvprogram.state.gov/>. Të regjistruarit duhet të kenë akses tek adresa e postë elektronike që vendosën tek aplikimi elektronik për E-DV.

17. Unë tashmë jam regjistruar në një kategori tjetër për vizë emigrimi. A mundem të aplikoj edhe për programin e DV-së?

Po.

18. A do të mundem të shkarkoj dhe ruaj formularin elektronik E-DV si dokument dhe ta plotësoj më pas?

Jo, ju nuk do të jeni në gjendje që të ruani formularin e plotësuar në një program tjetër dhe ta dorëzoni atë më vonë. Formulari i regjistrimit për lotarinë E-DV është formular vetëm për internet. Ju duhet të plotësoni informacionin dhe ta dorëzoni ndërkohë që jeni online.

19. A mundem të ruaj formularin në internet dhe ta përfundoj atë më vonë?

Jo. Formulari i regjistrimit të E-DV-së (lotarisë elektronike) është projektuar që të plotësohet dhe dorëzohet njëherësh. Ju do të keni gjashtëdhjetë (60) minuta kohë që fillon me shkarkimin dhe plotësimin e formularit, deri në përfundimin dhe regjistrimin në adresën e internetit të E-DV-së. Nëse më shumë se gjashtëdhjetë minuta kalojnë dhe ju nuk e keni përfunduar dhe regjistruar formularin tuaj

në mënyrë elektronike, informacioni i dhënë deri në atë moment do të fshihet. Sistemi fshin të gjitha regjistrimet e pjeshme që më vonë të mos përcaktohet aksidentalisht si duplikatë apo formular.

Lexoni deri në fund udhëzimet përpara se të filloni plotësimin e formularit, që të dini saktësisht çfarë informacioni do t'ju nevojitet.

20. Unë nuk kam skaner. A mundem të dërgoj fotografitë tek dikush në Shtetet e Bashkuara për t'i skanuar, ruajtur dhe postuar përsëri tek unë që t'i përdor në regjistrimin tim?

Po, kjo mund të bëhet për aq kohë sa fotografia plotëson kërkesat sipas udhëzimeve dhe dërgohet elektronikisht në të njëjtën kohë me regjistrimin elektronik të lotarisë E-DV. Ju duhet të keni fotografinë e skanuar në formular kur të regjistroheni elektronikisht për programin; fotografia nuk mund të paraqitet veçmas formularit elektronik. Regjistrimi i plotë (fotografi dhe formular së bashku), mund të plotësohet në mënyrë elektronike nga Shtetet e Bashkuara apo nga jashtë.

21. Nëse sistemi nuk ma pranoi formularin fillestar E-DV, a mundem të ridërgoj formularin tim?

Po, për sa kohë që aplikimi juaj dorëzohet përpara orës 12:00 (mesditë), Ora Standarte Lindore (EDT) (GMT-5) e martë, 8 nëntor 2022. Ju nuk do të penalizoheni për paraqitjen e një hyrjeje te dytë nëse sistemi E-DV refuzon hyrjen tuaj fillestare. Duke pasur parasysh natyrën e paparashikueshme të internetit, mund të mos merrni njoftimin e refuzimit menjëherë. Mund të përpiqeni të paraqisni një kërkesë sa herë që të jetë e nevojshme derisa të merret një aplikim i plotë dhe të dërgohet njoftimi i konfirmimit. Pasi të merrni një njoftim konfirmimi, hyrja juaj ka përfunduar dhe NUK duhet të paraqisni aplikim tjetër.

22. Sa shpejt pas regjistrimit të formularit do të marr njoftimin për konfirmimin elektronik?

Ju duhet të merrni njoftimin konfirmues menjëherë, sëbashku me numrin e konfirmimit i cili duhet ruajtur dhe mbajtur. Megjithatë, duke u nisur nga natyra e paparashikueshme e internetit, mund të njoftoheni me vonesë. Ju mund të shtypni butonin "Submit" sa herë të jetë e nevojshme deri në pranimin e plotë të formularit dhe deri në njoftimin për marrjen e konfirmimit. Megjithatë, sapo të merrni njoftimin konfirmues, mos e ridërgoni informacionin tuaj.

23. Unë e klikova butonin "Submit", por nuk m'u shfaq një numër konfirmimi. Nëse unë plotësoj e dorëzoj një regjistrim tjetër, a do të s'kualifikohem?

Nëse juve nuk ju shfaq numri i konfirmimit, regjistrimi juaj nuk është pranuar nga sistemi. Ju duhet të dorëzoni një regjistrim të ri. Ai nuk do të llogaritet si duplikatë. Sapo të keni marrë numrin e konfirmimit, mos kryeni më regjistrim tjetër në emrin tuaj.

PËRZGJEDHJA

24. Si mund ta di nëse unë jam përzgjedhur?

Ju duhet të përdorni numrin tuaj të konfirmimit për të hyrë tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve (Entrant Status Check), që bëhet aktive në faqen e internetit të E-DV-së <https://dvprogram.state.gov/> nga 6 maji 2023 deri në 30 shtator 2024. Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve është mënyra e vetme që do t'ju njoftojë juve për përzgjedhjen, do t'ju ofrojë udhëzime të mëtejshme sesi të vazhdoni aplikimin, t'ju njoftojë për datën dhe orën e takimit të intervistës për vizë. Faqja e vetme e internetit e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për regjistrimin e Vizës së Shumëllojshmërisë dhe për të Kontrolluar Statusin e të Regjistruarve (Entrant Status Check) është <https://dvprogram.state.gov/>.

Departamenti i Shtetit NUK do t'ju kontaktojë që t'ju njoftojë nëse jeni përzgjedhur (shikoni Pyetje të Bëra Shpesh #24).

25. Si do ta dalloj nëse nuk jam përzgjedhur? A do të njoftohem?

Ju mund të kontrolloni statusin e regjistrimit tuaj për DV-2024 nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve (*Entrant Status Check*) në faqen e internetit E-DV <https://dvprogram.state.gov/> duke filluar nga 6 maji 2023, deri më 30 shtator 2024. Ruajeni numrin tuaj të konfirmimit të paktën deri më 30 shtator 2024.

26. Po nëse humbas numrin tim të konfirmimit?

Ju duhet të keni numrin tuaj të konfirmimit që të hyni tek Kontrolli i Statusit të të Regjistruarve. Një buton është tani në dispozicion në Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve në faqen e internetit E-DV që do t'ju lejojë të rifitoni numrin tuaj të konfirmimit përmes adresës së regjistruar të postës elektronike duke plotësuar informacione të caktuara personale për të konfirmuar identitetin tuaj.

Ambasadat dhe Konsullatat e SHBA-së dhe Qendra Konsullore në Kentucky nuk janë në gjendje që të kontrollojnë statusin tuaj të regjistrimit për ju apo të sigurojnë numrin tuaj të konfirmimit tek ju direkt (përveç butonit gjetës nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit). Departamenti i Shtetit NUK mundet të sigurojë një listë të atyre që përzgjidhen për të vazhduar procesin e vizave.

27. A do të marr unë informacion nga Departamenti i Shtetit me adresë elektronike (e-mail) apo me postë?

Departamenti i Shtetit nuk do t'ju dërgojë një letër njoftimi. Qeveria amerikane asnjëherë nuk ka dërguar e-mail për të njoftuar ata individë që kanë janë të përzgjedhur, dhe nuk planifikon që të përdorë e-mail për qëllimi të tilla si programin e DV-2024. Nëse ju jeni përzgjedhur, ju do të merrni e-mail komunikimi vetëm në lidhje me caktimin tuaj për vizë, pas t'i jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit mbi Kontrollin e Statusit të të Regjistruarve. Këto e-maile nuk do të përmbajnë informacion mbi datën dhe kohën e takimit ekzistues, thjesht do t'ju tregojnë se detajet takimit janë në dispozicion dhe ju duhet pastaj të kontrolloni Statusin e të Regjistruarve për informacion të detajuar për çështjen tuaj.

Vetëm faqet e internetit që përfundojnë me prapashtesën ".gov" janë faqet zyrtare të internetit të qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Shumë faqet e internetit të tjera (p.sh., me prapashtesat ". Com", ". Org," ose ". Net") mund të sigurojnë informacione në lidhje me emigracionin dhe shërbimet e vizave. Departamenti i Shtetit nuk i vërteton, nuk i rekomandon, as sponsorizon informacionin ose materialin në këto faqet e tjera të internetit.

Ju mund të merrni email nga faqet interneti që përpiqen t'ju mashtrojnë t'u dërgoni para apo informacionin tuaj personal. Mund t'ju kërkohet që të paguani për formularët dhe informacionet në lidhje me procedurat e emigracionit, të cilat janë të gjitha në dispozicion falas në faqen e internetit të Departamentit të Shtetit ose përmes Ambasadës Amerikane apo faqet e internetit të Konsullatës. Përveç kësaj, organizatat apo faqet e internetit mund të përpiqen të vjedhin paratë tuaja duke ju ngarkuar pagesa për shërbime të lidhura me llotarinë. Nëse ju i dërgoni të holla ndokujt prej këtyre mashtrimeve,

mund të ketë të ngjarë që ju kurrë nuk ta shihni ata përsëri. Gjithashtu, mos dërgoni informacion personal në këto faqe e interneti, pasi mund të përdoret për mashtrim ose vjedhje të identitetit.

Këto emaile mashtruese mund të vijnë nga njerëz që pretendojnë se kanë lidhje me Qendrën Konsullore Kentucky, apo me Departamentin e Shtetit. **Mbani mend që Departamentin e Shtetit të SHBA-së nuk ka dërguar asnjëherë emaile për të njoftuar aplikantët që ata janë përzgjedhur dhe që nuk ka në plan të përdorë emailin për këtë qëllim për programin DV-2023. Departamenti i Shtetit nuk do t'ju kërkojë juve të dërgoni para me postë, apo me shërbime si Western Union.**

28. Sa individë do të përzgjidhen për DV-2024?

Për DV-2024 janë në dispozicion 55,000 viza DV. Për shkak se ka të ngjarë që një pjesë e 55,000 aplikantëve të përzgjedhur nuk do të kualifikohen ose nuk do të ndjekin (vazhdojnë) rastet e tyre për lëshimin e vizave, më shumë se 55,000 regjistrime do të përzgjidhen për të siguruar që të gjitha vizat e vëna në dispozicion për lotarinë të jenë lëshuar. Gjithsesi, kjo gjithashtu do të thotë se mund të mos ketë një numër të mjaftueshëm vizash për të gjithë ata që janë përzgjedhur fillimisht.

Ju mund të kontrolloni nëpërmjet Statusit të Regjistruarve (Entrant Status Check) dhe në faqen e internetit të E-DV-së nëse jeni përzgjedhur për procesim të mëtejshëm, si dhe për radhitjen e tyre në listë. Intervistat për programin e DV-2024-s do të fillojnë në Tetor 2023 për ata të përzgjedhur të cilët kanë dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar para intervistës dhe informacion tjetër siç mund t'u jetë kërkuar në udhëzimet e njoftimit. Të përzgjedhurit, të cilët plotësojnë informacionin e kërkuar në udhëzime, do të informohen për datën e intervistës së tyre për vizë nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve në faqen e internetit të E-DV-së katër deri në gjashtë javë para intervistës së planifikuar me zyrtarët konsullorë të SHBA-së në vendet e huaja.

Çdo muaj, do të lëshohen viza për aplikantët që kualifikohen gjatë atij muaji, aq sa lejon numri në dispozicion për lëshimin e vizave. Pasi të gjitha 55,000 vizat për llotari të jenë lëshuar, programi do të përfundojë. Në parim, numrat e vizave mund të përfundojnë përpara shtatorit 2024. Aplikantët e përzgjedhur të cilët dëshirojnë të marrin vizë duhet të jenë të përgatitur që të dokumentojnë me përpikmëri dosjet e tyre. **Të jesh thjesht i përzgjedhur rastësisht nuk garanton që ju do të merrni një vizë. Përzgjedhje do të thotë vetëm që ju jeni i ligjshëm të aplikoni për një Vizë Shumëllojshmërie (lotarie), dhe nëse numri i dosjes suaj bëhet aktual për shqyrtimin final, ekziston mundësia për lëshimin e vizës së lotarisë. Maksimumi 55,000 viza mund t'u lëshohen aplikantëve të tillë.**

29. Si do të përzgjidhen të regjistruarit e suksesshëm?

Njoftimet zyrtare të përzgjedhjes do të bëhet nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve, duke filluar nga 6 maji 2023, deri në 30 shtator 2024, në faqen e internetit E-DV <https://dvprogram.state.gov/>. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë njoftime për të përzgjedhurit apo letra me postë ose email. Çdo njoftim me email ose letër që ju deklaron se jeni përzgjedhur për të marrë lotarinë nuk vjen nga Departamenti i Shtetit dhe nuk është i ligjshëm. Çdo komunikim me email që ju merrni nga Departamenti i Shtetit do t'ju drejtojë juve për të rishikuar Kontrollit të Statusit të Regjistruarve për informacion të ri në lidhje me aplikimin tuaj. Departamenti i Shtetit nuk do t'ju kërkojë kurrë të dërgoni para me postë apo me shërbime të tilla si Western Union.

Të gjitha regjistrimeve të marra nga secili rajon do u caktohet një numër individual dhe në përfundim të periudhës së regjistrimit, një kompjuter do të përzgjedhë rastësisht aplikime të marra nga secili rajon gjeografik. Brenda secilit rajon, aplikimi i parë i zgjedhur rastësisht do të jetë rasti i parë i regjistruar, aplikimi i dytë i përzgjedhur do të jetë rasti i dytë i regjistruar, etj. Të gjitha regjistrimet e marra gjatë periudhës së aplikimit do të ketë një shans të barabartë për të qenë të përzgjedhur në çdo rajon. Kur një regjistrim është përzgjedhur, aplikanti do të njoftohet për zgjedhjen e tij/saj nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve (Entrant Status Check) që do të vihet në dispozicion nga 6 maji 2023 në faqen e internetit të E-DV-së <https://dvprogram.state.gov/>. Në qoftë se ju jeni përzgjedhur dhe ndiqni udhëzimet e dhëna online nëpërmjet Kontrollit të Statusit të të Regjistruarve, Qendra Konsullore në Kentucky (KCC) e Departamentit të Shtetit do të shqyrtojë rastin derisa kandidatët e përzgjedhur për intervistë të marrin udhëzimet për t'u paraqitur në intervistë për vizë në një Ambasadë ose Konsullatë të SHBA, ose derisa ata që ndodhen në SHBA, të aplikojnë në një zyrë lokale të USCIS për të rregulluar statusin.

30. Unë ndodhem tashmë në Shtetet e Bashkuara. Nëse përzgjidhem, a mund të rregulloj statusin pranë USCIS?

Po, ju mund të aplikoni pranë USCIS për rregullim të statusit si banor i përhershëm me kusht që ju të jeni i pranueshëm për të rregulluar statusin sipas kushteve ligjore të nenit 245 të INA-s. Ju duhet të siguroheni që USCIS do të mbarojë veprimet në rastin tuaj, duke përfshirë shqyrtimin para 30 shtatorit 2024 edhe të ndonjë bashkëshorti/bashkëshorteje apo fëmije nën moshën 21 vjeç që ndodhen jashtë Amerikës, pasi në atë datë mbaron përzgjedhja juaj për programin e DV-2024. Në asnjë rrethanë nuk do të miratohen numra vizash të programit të DV-2024 apo rregullim i statusit pas mesnatës (EDT) më 30 shtator 2024.

31. Nëse jam përzgjedhur, për sa kohë kam të drejtë të aplikoj për një vizë të kategorisë së DV-së?

Personat e përzgjedhur për programin e lotarisë DV-2024 kanë të drejtë të aplikojnë për lëshimin e vizave vetëm gjatë vitit fiskal 2024 të Departamentit të Shtetit, i cili shtrihet nga 1 tetori 2023 deri më 30 shtator 2024.

Pa përjashtim, të gjithë aplikantët e përzgjedhur dhe të pranueshëm duhet të pajisen me vizë ose të rregullojnë statusin e tyre deri në përfundim të vitit fiskal. Nuk përfitojnë asnjë shtyrje të lotarisë për vitin e ardhshëm personat që janë përzgjedhur, por që nuk janë pajisur me vizë deri më 30 shtator 2024 (fundi i vitit fiskal). Gjithashtu, bashkëshortët dhe fëmijët që përfitojnë nga statusi i një të regjistruari të DV-2024 mund të pajisen me viza në kategorinë e DV-së vetëm nga 1 tetori 2023 deri më 30 shtator 2024. Aplikantët që aplikojnë jashtë kufijve të Amerikës do të marrin një njoftim nga Departamenti nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistrimit në faqen e internetit të E-DV-së katër deri në gjashtë javë përpara datës së takimit të planifikuar për intervistë.

32. Nëse një i përzgjedhur për programin e DV vdes, çfarë ndodh me rastin?

Nëse një i përzgjedhur kryesor vdes në cilindo hap të procesit të vizës përpara se të udhëtojë në Shtetet e Bashkuara, rasti i DV-së do të anulohet automatikisht. Çdo bashkëshort/e dhe fëmijët derivativë nuk kanë më të drejtë për vizë lotarie. Çdo vizë që i ishte lëshuar atyre do të anulohet.

TARIFAT

33. Sa kushton regjistrimi në programin e E-DV-së?

Nuk ka asnjë tarifë për t'u regjistruar elektronikisht për lotarinë. Sidoqoftë, nëse ju jeni përzgjedhur, duhet të paguani të gjitha tarifat për vizë të kërkuara në kohën e aplikimit për vizë si dhe intervistë drejtpërdrejt tek arkëtari konsullor në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara apo Konsullatë. Nëse ju jeni një i përzgjedhur që ndodheni tashmë në SHBA, dhe aplikoni pranë USCIS për të rregulluar statusin, ju do t'i paguani të gjitha tarifat e kërkuara direkt pranë USCIS. Nëse jeni përzgjedhur, ju do t'i merrni detajet mbi tarifat e kërkuara të aplikimit për vizë emigrimi të DV-së bashkë me udhëzimet e dhëna nëpërmjet faqes së internetit të E-DV-së në <https://dvprogram.state.gov/>

34. Si dhe ku do të paguaj tarifat e vizës së emigrimit dhe DV-së nëse jam i përzgjedhur?

Nëse ju jeni një aplikues i përzgjedhur rastësisht, ju do të merrni udhëzimet mbi shqyrtimin e aplikimit të vizës së DV-së nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek <https://dvprogram.state.gov/>. Ju do të paguani të gjitha tarifat e DV-së dhe vizës së emigrimit personalisht vetëm në Ambasadën ose Konsullatën e SHBA -së në kohën e aplikimit për vizë. Arkëtari konsullor do t'ju japë menjëherë një faturë të qeverisë së SHBA-së për pagesën. Mos i dërgoni para askujt për tarifat e DV-së nëpërmjet postës, Western Union, ose kujtdo shërbimi tjetër dërgesash nëse ju jeni duke aplikuar për një vizë emigrimi në një Ambasadë ose Konsullatë të Shteteve të Bashkuara.

Nëse ju jeni përzgjedhur dhe ndodheni tashmë në Shtetet e Bashkuara, dhe planifikoni të depozitoni një kërkesë për rregullimin e statusit pranë USCIS, fleta e udhëzimeve e aksesueshme nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve tek <https://dvprogram.state.gov/> përmban udhëzime të veçanta se si të dërgoni tarifat e DV-së pranë një banke amerikane.

35. Nëse aplikoj për DV, por nuk kualifikohem për të marrë një vizë të tillë, a mund të më rimburohet tarifa që kam paguar për vizë?

Jo. Tarifat e vizave nuk mund të rimburohen. Ju duhet të përmbushni kualifikimet për vizë ashtu siç është specifikuar në këto udhëzime. Në rast se zyrtari konsullor vendos se ju nuk i përmbushni të gjitha kërkesat për vizë ose se ju nuk jeni i pranueshëm për Vizën e Shumëllojshmërisë, sipas ligjit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, oficeri nuk mund t'ju lëshojë vizë dhe do t'ju mbahen tarifat e paguara.

PAPRANUESHMËRITË

36. Si një aplikant DV-je, a mund të marr falje për çfarëdo rast të papranueshmërisë për vizë? A konsiderohet sipas një shqyrtimi special aplikimi im për falje?

Aplikantët e DV-së janë subjekt i të gjitha rasteve të papranueshmërisë për vizat emigruese të specifikuar në Aktin e Emigracionit dhe Shtetësisë (INA). Nuk parashikohen dispozita të veçanta për falje të asnjë rasti të papranueshmërisë për vizë duke lënë mënjane ato të parashikuara zakonisht në INA, as nuk ka shqyrtim të veçantë për kërkesat për falje. Disa dispozita të përgjithshme për falje për njerëzit që kanë të afërm të ngushtë që janë nënshtruar të SHBA-së ose të huajve rezidentë të përhershëm të ligjshëm mund të jenë të disponueshme edhe për aplikantët e DV-së në disa raste, por koha e kufizuar për programin e DV-së do ta bëjë të vështirë që aplikantët të përfitojnë nga dispozita të tilla.

PARALAJMËRIMET DHE MASHTRIMET MBI DV-në

37. Si mund ta raportoj mashtrimin në internet ose një email të padëshiruar?

Ju lutemi vizitoni faqen e internetit www.econsumer.gov, të organizuar nga Komisioni Federal i Tregtisë, në bashkëpunim me agjencitë për mbrojtjen e konsumatorit nga 36 shtete. Ju gjithashtu mund të

raportoni mashtrimin në Zyrën Federale të Hetimeve (FBI) [Qendra e Ankesës për Krimin në Internet \(Internet Crime Complaint Center\)](#). Për të depozituar një ankesë rreth një emaili të padëshiruar, vizitoni faqen e Departamentit të Drejtësisë ([Department of Justice Contact Us page](#)).

STATISTIKAT E DV-së

38. Sa viza do lëshohen për DV-2024?

Sipas ligjit, një maksimum prej 55,000 vizash janë të disponueshme çdo vit për personat e pranueshëm.

TË NDRYSHME

39. Nëse unë marr një vizë nëpërmjet programit të DV-së, a do të më paguajë qeveria e SHBA-së pagesën e udhëtimit për në SHBA, a do të më ndihmojë për të gjetur strehim dhe punë dhe/ose a do më japë kujdes mjekësor apo ndonjë ndihmë tjetër financiare derisa unë të rregullohem plotësisht?

Jo. Qeveria e SHBA-së nuk do të japë asnjë nga këto shërbime nëse ju merrni një vizë nëpërmjet programit të DV-së. Nëse ju jeni përzgjedhur për të aplikuar për një vizë DV-je, do t'ju kërkohet të dëshmoni se nuk do të bëheni barrë publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara se të pajiseni me vizë. Këto të dhëna mund të jetë në formën e një kombinimi të pasurive tuaja personale, një Garanci Mbështetjeje (Formulari I-134), i paraqitur nga një i afërm apo mik që banon në Shtetet e Bashkuara, një ofertë për punësim nga një punëdhënës në Shtetet e Bashkuara, ose evidencë tjetër.

LISTA E VENDEVE/ZONAVE SIPAS RAJONIT, VENDASIT (TË LINDURIT) E TË CILËVE JANË TË PRANUESHËM (kanë të drejtë të aplikojnë) PËR LOTARINË DV-2024

Lista e mëposhtme paraqet vendet, vendasit (të lindurit) e të cilëve janë të ligjshëm për Lotarinë DV-2024, të grupuar sipas rajonit gjeografik. Zonat e jashtme në varësi janë përfshirë brenda rajonit të shtetit që e qeveris. Vendet, banorët (të lindurit) e të cilëve janë të pranueshëm për programin e lotarisë DV-2024 janë identifikuar nga USCIS (Shërbimi i Emigracionit dhe Nënshitetësisë të Shteteve të Bashkuara), sipas formulës së Seksionit 203(c) të INA-s. Vendet, vendasit (të lindurit) e të cilëve nuk janë të pranueshëm për programin e lotarisë DV (sepse janë burimi kryesor i emigracionit me sponsorizim familjar dhe i emigracionit me bazë punësimi ose vende me "përqindje të lartë të pranimit të emigrantëve") janë të renditura pas listës respektive rajonale.

AFRIKA

Algjeria

Angola

Benini

Botsvana

Burkina Faso

Burundi

Kameruni

Kepi Jeshil

Republika e Afrikës Qëndrore

Çadi

Komoros

Kongo

Republika Demokratike e Kongos

Bregu i Fildishtë

Xhibuti

Egjipti*

Guinea Ekuatoriale

Eritrea

Esvatini

Etiopia

Gaboni

Gambia

Gana

Guinea

Guinea-Bissau

Kenia

Lesoto	Senegali
Liberia	Sejshell
Libia	Sierra Leone
Madagaskar	Somalia
Malavi	Afrika e Jugut
Mali	Sudani Jugor
Mauritania	Sudani
Mauricius	Tanzania
Maroku	Togo
Mozambiku	Tunizia
Namibia	Uganda
Nigeri	Zambia
Ruanda	Zimbabve
Sao Tome dhe Principe	

*Personat e lindur në zonat e administruara para qershorit 1967 nga Izraeli, Jordania, Siria dhe Egjipti, janë respektivisht në ngarkim të Izraelit, Jordanisë, Sirisë dhe Egjiptit. Personat e lindur në Rripin e Gazës janë në ngarkim të Egjiptit; personat e lindur në Bregun Perëndimor janë në ngarkim të Jordanisë; personat e lindur në Lartësitë Golan janë në ngarkim të Sirisë. Në Afrikë, vendasit/personat e lindur në Nigeri **nuk** janë të pranueshëm për programin e lotarisë së këtij viti.

AZIA

Afganistani	Ishujt Maldive
Bahreini	Mongolia
Butani	Nepal
Brunei	Koreja e Veriut
Burma	Omani
Kamboxia	Katar
Indonezia	Arabia Saudite
Iran	Singapori
Irak	Sri Lanka
Izraeli*	Siria*
Japonia***	Tajvan*
Jordania*	Tajlanda
Kuvaiti	Timor-Leste
Laos	Emiratet e Bashkuara Arabe
Libani	Jemeni
Malajzia	

* Personat e lindur në zonat e administruara para qershorit 1967 nga Izraeli, Jordania, Siria dhe Egjipti ngarkohen, përkatësisht, për Izraelin, Jordaninë, Sirinë dhe Egjiptin. Personat e lindur në Rripin e Gazës i ngarkohen Egjiptit; personat e lindur në Bregun Perëndimor i ngarkohen Jordanisë; personat e lindur në Lartësitë Golan i ngarkohen Sirisë..

** Macau S.A.R. (Rajoni i Evropës, i ngarkueshëm me Portugalinë,) dhe Tajvani (rajoni i Azisë) kualifikohen dhe renditen këtu. Vetëm për qëllime të programit të diversitetit, personat e lindur në Macau S.A.R. nxjerr të drejtën nga Portugalia.

***Personat e lindur në Ishujt Habomai, Shikotan, Kunashiri dhe Etorofu ngarkohen për Japoninë. Personat e lindur në Sakhalin Jugor janë të ngarkuar me Rusinë. Vendasit e vendeve të rajonit të Azisë vijuese **nuk** janë të pranueshëm për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë së këtij viti: Bangladeshi, Kina (i lindur në kontinent duke përfshirë Hong Kong), India, Pakistani, Koreja e Jugut, Filipinet dhe Vietnami.

EUROPA

Shqipëria	Rajoni me Administrim të Veçantë i Makaut**
Andora	Maqedonia e Veriut
Armenia	Malta
Austria	Moldavia
Azerbaixhani	Monako
Bjellorusi	Mali I Zi
Belgjika	Holanda (përfshirë vendet në varësi të saj)
Bosnja dhe Herzegovina	Irlanda e Veriut***
Bullgaria	Norvegjia (përfshirë vendet në varësi të saj)
Kroacia	Polonia
Qipro	Portugalia (përfshirë vendet në varësi të saj)
Republika Çeke	Rumania
Danimarka (përfshirë vendet në varësi të saj)	Rusia****
Estonia	San Marino
Finlanda	Serbia
France (përfshirë vendet në varësi të saj)	Slovakia
Gjeorgjia	Slovenia
Gjermani	Spanja
Greqi	Suedia
Hungaria	Zvicra
Islanda	Taxhikistan
Irlanda	Turqi
Itali	Turkmenistan
Kazakistan	Ukraine
Kosova	Uzbekistan
Kirgizstani	Qyteti i Vatikanit
Letonia	
Liechtenstein	
Lituania	
Luksemburg	

** Makau S.A.R. **kualifikohet** dhe është renditur më lart vetëm për qëllimet e programit të Lotarisë; personat e lindur në Macau S.A.R. marrin të drejtën nga Portugalia.

*** Vetëm për qëllimet e programit të Lotarisë, Irlanda e Veriut do trajtohet veçmas, Irlanda e Veriut **kualifikohet** dhe është renditur mes vendeve kualifikuese.

**** Personat e lindur në Ishujt Habomai, Shikotan, Kunashiri dhe Etorofu i detyrohen Japonisë. Personat e lindur në Sakhalin Jugor i detyrohen Rusisë.

Të lindurit e vendeve të Europës të renditura si më poshtë, **nuk** kanë të drejtë të aplikojnë për programin e Lotarisë së këtij viti: Britania e Madhe. Britania e Madhe përfshin këto vendet të varura prej saj: Anguila, Bermuda, Ishujt Britanikë Virxhin, Ishujt Kajman, Ishujt Falkland, Gjibraltari, Montserrat, Pitkairn, Shën Helena dhe Ishujt Kaikos dhe Turk.

AMERIKA E VERIUT

Bahamas

Në Amerikën e Veriut, të lindurit në Kanada dhe Meksikë **nuk** kanë të drejtë të aplikojnë për programin e lotarisë së këtij viti.

OQEANIA

Australia (përfshirë vendet në varësi të saj)

Fixhi

Kiribati

Ishujt Marshall

Mikronezia, Federata e Shteteve të

Nauru

Zelanda e Re (përfshirë vendet në varësi të saj)

Palau

Papua Guinea e Re

Ishujt Solomon

Tonga

Tuvalu

Vanuatu

Samoa

AMERIKA e JUGUT, AMERIKA QËNDRORE DHE KARAIBET

Antigua dhe Barbuda

Argjentina

Barbados

Belize

Bolivia

Kili

Kosta Rika

Kuba

Dominika

Ekuadori

Grenada

Peru

Guijana

Nikaragua

Panama

Paraguaj

Shën Kits dhe Nevis

Santa Lucia

Saint Vincent dhe Grenadines

Suriname

Trinidad dhe Tobago

Uruguaj

Venezuela

Të lindurit në këto vende të rajonit **nuk** janë të ligjshëm (nuk kanë të drejtë të aplikojnë) për programin e lotarisë së këtij viti:

Brazili, Kolumbia, Republika Domenikane, El Salvadori, Guatemala, Haiti, Honduras, Xhamaika dhe Meksikë.